

RREGULLORE E LOJËS SË FATIT PROMOCIONALE

Sipas kërkesave të Ligji nr. 155/2015 “Për Lojrat e Fatit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 196/2017 “Për Përcaktimin e Mënyrave, Formave, Kritereve dhe Rregullave për Organizimin e Lojërave të Fatit Promocionale”,

Organizatori i Lojës Promocionale

Organizatori i Lojës Promocionale është Shoqëria “Dukat Water” sh.p.k, shoqëri tregtare e regjistruar dhe që ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin e Shqipërisë,

Lloji i lojës promocionale që do të organizohet

Loja promocionale është konceptuar si një lojë fati promocionale për blerësit e produkteve që shoqëria “Dukat Water” sh.p.k, tregton. Emërtimi i saj është “Po pi Dukat? Sa me fat”. Për tu bërë pjesë e shorteut duhet të kryhet një blerje për një nga produktet “Dukat Water” sh.p.k dhe kodin unik që ndodhet poshtë kapakut të produktit duhet ta regjistrojnë në adresën www.ujidukat.al/loja së bashku me disa të dhëna personale (si emër, mbiemër, numër telefoni dhe adresa e email) të cilat do të shërbejnë për identifikimin e përdoruesit. Përzgjedhja e fituesit do të kryhet në mënyrë rastësore nga regjistrimet e bëra online.

Kohëzgjatja e lojës

Platforma online për regjistrim do të fillojë të jetë aktive më 01 Qershor 2023 ora 00:01 dhe mbyllet më datë 31 Tetor 2023 ora 23:59.

Cdo 30 (tridhjetë) ditë do të hidhet shorti për shpalljen e fituesve mujor, të cilët do të kenë si afate kohore 15 ditë për tërheqjen e çmimeve dhe me datë 01 Nëntor 2023 do të hidhet shorti për fituesit e muajit të fundit dhe çmimit të madh.

Pra, shorteu i parë do të hidhet më datë 30.06.2023, shorteu i dytë me datë 31.07.2023, shorteu i tretë me datë 31.08.2023, shorteu i katërt me datë 30.09.2023 dhe shorteu i fundit me datë 01 Nëntor 2023.

Afatet për tërheqjen e produkteve nga ana e fituesve të shorteut të fundit do të jetë 16 Nëntor 2023 për çmimet e tjera dhe 30 Nëntor 2023 për tërheqjen e çmimit të madh.

E drejta e pjesëmarrjes

Mund të marrin pjesë në lojën promovionale të gjithë personat fizikë me rezidencë të përhershme në Republikën e Shqipërisë nëse janë mbi 18 vjeç.

Përshkrimi dhe ndarja e çmimeve

Shpërblimet mujore të lojës promovionale do të jenë:

- 1 fitues iPhone 14 - 128GB;
- 1 fitues Playstation 5;
- 1 fitues TV Samsung UE43AU7172UXXH;
- 2 fitues Scooter Xiaomi;
- 15 fitues Bluetooth Headphones;
- 20 fitues Top Volleyball;
- 15 fitues Sport Cap (Kapele) ;
- 5 fitues Bag (Çantë) B;
- 5 fitues Charging (Karikues) Brick;
- 5 fitues Smart Watch Xiaomi;
- 6 fitues Bluetooth Earphones;
- 50 fitues të termusit me logon Dukat Water;

Nga pjesëmarrja në lojën promovionale do të përzgjidhen 126 fitues në intervale kohore mujore dhe 1 fitues i çmimit të madh në mbyllje të shorteut, i cili do të fitojë një automjet model Kia Stonic LX Fun. Në total do të jenë 631 fitues.

Përzgjedhja e fituesve do të bazohet në metodën e përzgjedhjes rastësore, nëpërmjet platformës elektronike online.

Shoqëria “Dukat Water” sh.p.k mund të refuzojë dhënien e çmimeve në rast se konstaton se nuk janë respektuar kushtet e kësaj rregulloreje apo në rast se fituesi rezulton i tillë si rezultat i ndonjë parregullsie, truku dhe/apo mashtrimi.

Vlera monetare që duhet të paguajë pjesëmarrësi në lojë

Pjesëmarrësit nuk janë të detyruar të paguajnë asnjë lloj vlere monetare për t’u bërë pjesë e lojës promovionale. Pjesëmarrësit duhet vetëm të blejnë produktin ujë “Dukat Water”, me kapakun e të cilit do të mund të shpallen fitues.

Mekanizmi i lojës promovionale

Të gjithë konsumatorët e interesuar duhet të bëjnë një blerje të produkteve “Dukat Water” sh.p.k, (Uji Dukat 0.5L, Uji Dukat 1.5L, Uji Dukat 2L, Uji Dukat 5 L) në pikat e shitjes. Të gjithë këto produkte kanë një kod unik i cili ndodhet poshtë kapakut së shishes. Ky numër unik duhet si një

nga të dhënat e domosdoshme për t'u regjistruar në formën e programit kompiuterik, i cili do të ndodhet në adresën: www.ujidukat.al/loja

Këto të dhëna do të regjistrohen në databazën e programit kompjuterik me adresë www.ujidukat.al/loja, menaxhuar nga një inxhinier IT i specializuar i shoqërisë "Le spot production" sh.p.k.

Konsumatorët do të njoftohen me një mesazh në pajisjet e tyre mobile që janë bërë pjesë e lojës promovionale, nëse kanë fituar dhuratat mujore, me përcaktimin e dhuratës së fituar dhe faktit që tashmë pjesë e shorteut të madh, që do të hidhet në fund të periudhës promovionale.

Në çdo shorte, përzgjedhja e fituesve do të kryhet në mënyrë rastësore nga programi, i cili do të identifikojë numrin unik që ndodhet poshtë kapakut dhe do të kryejë lidhjen me të gjitha të dhënat e tjera, pjesë e formës së identifikimit (emri, mbiemri, numri i telefonit, E-mail).

Secili konsumator do të ketë të drejtën e marrjes pjesë në lojë, duke vendosur jo më shumë se 5 (pesë) kode të ndryshëm brenda 24 orëve. Secili konsumator pjesëmarrës në lojë nuk mund të vendosë me shumë se 1 (një) herë të njëjtin kod në platformën online.

Mënyra e përzgjedhjes së fituesve dhe vendi ku do të realizohet

Përzgjedhja e fituesve për dhuratat do të kryhet në mënyrë rastësore dhe të menjëherëshme me ndihmën e një programi kompjuterik. Pjesëmarrësit që regjistrohen për dhuratat mujore, bëhen pjesëmarrës në shorteun e çmimit të madh automatikisht.

Shpërndarja e dhuratave do të bëhet me dy mënyra, ku fituesi mund të zgjedhë:

- a) nëpërmjet shërbimeve postare, në adresat e fituesve,
- b) fituesit mund të tërheqin dhuratën nga e Hëna në të Premte, nga ora 10.00 deri më 12.30 në adresën: Rr. "3 krojet", Vaqarr, Tiranë ose Fshati Bishqethem, Lagjia "Rruga e Kishës", Kolonjë, Fier.

Tërheqja e dhuratave do të kryhet brenda një afati kohor prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh duke filluar nga e nesërmja e ditës së shpalljes së fituesve. Në rast se fituesi nuk paraqitet brenda këtij afati, dhurata/çmimi do të hidhet sërish në short, së bashku me dhuratat e muajit aktual.

Fituesi i çmimit të madh do të ketë një afat kohor prej 30 (tridhjetë) ditësh duke filluar nga e nesërmja e ditës së shpalljes së fituesit, për të tërhequr çmimin. Në hedhjen e shorteut për çmimin e madh, pas gjenerimit të fituesit të parë kryesor, do të gjenerohen deri në 4 (katër) kode, fituesish potencialë (rezervë), të cilët do të kenë mundësinë e kualifikimit të tyre si fitues me të drejta të plota, në rast se fituesi i parë nuk tërheq çmimin për shkak se ndodhet në kushtet e cituara në pikën të kësaj rregulloreje.

Tërheqja e dhuratës mund të kryhet me paraqitjen e dokumentit të identifikimit të fituesit, kartë identiteti ose pasaportë. Çdo fitues duhet të firmosë në momentin e marrjes së dhuratës procesverbalin e marrjes në dorëzim të dhuratës si dhe faturën e shoqërimit. Të gjithë fituesit duhet të tërheqin personalisht dhuratat. Në pamundësi për të qenë prezent, fituesi nëpërmjet një prokure mund të autorizojë një person të tretë në tërheqjen e çmimit.

Çmimet do të konsiderohen si të refuzuara në rast se:

- a) fituesit nuk paraqiten brenda afateve të caktuara në pikat mesiper për tërheqjen e çmimeve, këto çmime do të konsiderohen si të refuzuara dhe për këtë arsye do të hidhen sërish në short;
- b) fituesit nuk kanë vendosur të dhëna të sakta në platformën online si: emër, mbiemër (jo nickname), nr telefoni i saktë, adresë e saktë,
- c) fituesi nuk pranon të nënshkruajë procesverbalin në momentin e marrjes së dhuratës në dorëzim.
- d) fituesi është në përmbushje të kushteve të përcaktimeve të kesaj rregullore,

Përzgjedhja e fituesit të çmimit të madh do të kryhet në mënyrë rastësore nga program kompjuterik nga e gjithë databaza e aplikuesve.

Kufizime

Nuk do të konsiderohen të vlefshme aplikimet në rastet kur :

- Vendosja e një kodi në platformën online me shumë së një herë;
- Pjesëmarrja në lojë e punëmarrësve (stafit) të shoqërisë “Dukat Water” shpk si dhe stafit të shoqërisë bashkëpunuese në organizimin e lojës “Le spot production” sh.p.k;
- Vendosja e kodit të kapakut në platformën online pas afatit të zhvillimit të lojës pra pas datës 31 Tetor 2023.

Mënyra e njoftimit të fituesve

Fituesit do të njoftohen nëpërmjet një mesazhi ne pajisjen e tyre mobile të vendosur në momentin që kanë aplikuar në lojën promovionale.

Hedhja e shorteut për çmimin e madh

Hedhja e shorteut për dhuratën e çmimit të madh të përcaktuar në këtë rregullore do të bëhet në datën 01 Nëntor 2023, në orën 10.30, pranë selisë së shoqërisë, në praninë personave të pranishëm të cilët do të jenë: një Përfaqësues i AMLF, një Përfaqësues nga Drejtoria Tatimore dhe një punojës i autorizuar nga “Dukat Water” sh.p.k.

Afatet për tërheqjen e produkteve nga ana e fituesve të shorteut të fundit do të jetë 16 Nëntor 2023 për çmimet e tjera dhe 30 Nëntor 2023 për tërheqjen e çmimit të madh.

Në rast të mostërheqjes së çmimit të madh brenda datës 30 Nëntor 2023, nga fituesi i parë i përzgjedhur nga sistemi, referuar kësaj rregulloreje, çmimi fitues i kalon të përzgjedhurit të dytë. Në rast të përsëritjes së të njëjtës situatë, çmimi i madh i kalon të përzgjedhurit të tretë e kështu me rradhë.

Çmimi i madh përfshin një makinë Kia Stonic LX Fun me specifikat e mëposhtme:

Përfundimi i lojës

Loja do të konsiderohet e përfunduar me mbarimin e afateve kohore dhe realizimin e objektit të saj pra shpërndarjen e dhuratave drejt fituesve.

Njoftimi për ndërprerjen dhe çdo njoftim tjetër i rëndësishëm në lidhje me Lojën e Fatit Promocionale, do të publikohet në faqen zyrtare të shoqërisë “Dukat Water” shpk.

Shoqëria “Dukat Water” shpk mund të ndryshojë kushtet e kësaj Lojë Promocionale, vetëm pasi të ketë marrë miratimin paraprak të AMLF.

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe është e vlefshme deri në përfundim të kësaj loje promovionale.